



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ /2018

V E N D I M

Nr. 24 , Datë 11 / 1 /2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me Nr.138, datë 25.10.2017, e paraqitur nga B.K¹, kundër Bashkisë Tiranë, Drejtorisë Vendore të Policisë së Shtetit Tiranë, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit – Bashkia Tiranë dhe Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës”, “ngjyrës”, “etnisë”, “gjendjes ekonomike” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

KONSTATOI:

B.K në ankesën e paraqitur shkurtimisht shpjegon se: “Në pallatin ku banon në katin e parë është ndërtuar Bar Kafe “DOFF”. Zhvillimi i aktivitetit të kësaj njësie i ka sjellë shqetësime të vazhdueshme që nuk i lejojnë një jetesë normale në banesën e tij. Është ankuar disa herë për zhurmat e shkaktuara dhe për shqetësime të tjera nga personat që ushtrojnë aktivitetin pasi pronarët kanë zmadhuar dhe zgjeruar sipërfaqen e lokalit dhe kanë bllokuar tërësisht aksesin dhe ajrimin në pronën e tij. Për situatën e krijuar, është ankuar tek disa institucione si: Njësia Administrative nr.5 Tiranë, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit – Bashkia Tiranë, Komisarariatit të Policisë nr.2 Tiranë, Policisë Bashkiake Tiranë, IKMT, etj por problemi i tij nuk ka marrë zgjidhje. Sipas shkresës nr.31694/1, datë 15.09.2017 të Kryeinspektorit të IMT-Bashkia Tiranë, referohet se janë mbajtur dy herë procedurat për konstatimin e kundërvajtjes për shtetasin A.V, në datë 14.06.2017 dhe 29.08.2017 në të cilat është vendosur gjobë si dhe është dhënë vendimi për prishje objekti nr.162, datë 08.09.2017 por përsëri problemi i tij nuk është zgjidhur”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe ti rikthehet e drejta për të gëzuar i qetë dhe i pacënuar jetesën në banesën e tij.

¹ B.K deklaron se i përket komunitetit rom.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen dhe ka kërkuar nga ankuesi shpjegime, dokumentacion dhe informacion më të plotë.

- Për këtë arsye, me shkresën nr. 1027/1, datë 02.11.2017, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ka kërkuar ankuesit të paraqesë këto dokumente: - Dokumentacion apo vërtetim për të provuar përkatësinë etnike (raca), gjendjen ekonomike dhe “çdo shkak tjetër” si shkaqe të pretenduara për trajtim të pabarabartë dhe shpjegime, fakte dhe prova që do të provonin lidhjen shkakësore të trajtimit të pabarabartë për shkaqet e diskriminimit të pretenduar: raca dhe gjendja ekonomike nga ana e përfaqësuesve të: - Bashkisë Tiranë, - Drejtorisë Vendore të Policisë së Shtetit, Tiranë, - Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Tiranë, - Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

B.K ka marrë dijëni për shkresën me anë të: Lajmërim marrje poste nr. RR 091 498 044 AA datë 03.11.2017.

Subjekti ankues, me gjithë afatin kohor që kishte në dispozicion, nuk përmbushi kërkesat ligjore për dërgimin e informacionit të kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33/2, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/ç, 7 dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës të shtetasit B.K për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI